



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 28, Datë 22.02.2024

MBI

**NJOHJEN E LICENCËS PËR TREGTIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE, LËSHUAR
NGA ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI E REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PËR
SUBJEKTIN “MONTING” SH.P.K.**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 97, pikës 6 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pikës 4 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen, dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.02.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 594/3 prot., datë 15.02.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi njohjen e licencës për tregtimin e energjisë elektrike, lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji e Republikës së Kosovës, për subjektin “MONTING” sh.p.k.”

Konstatoi se:

- Subjekti “MONTING”, degë e shoqërisë së huaj, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 594, datë 07.02.2024, paraqiti kërkesën për njohje të licencës së tregtimit të energjisë elektrike, me numër ZRRE/Li_91/23, lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji në Republikën e Kosovës, me vendimin V_1756_2023, datë 18.08.2023, për subjektin “MONTING” sh.p.k.
- Me e-mailin e protokolluar me nr. 594/1 prot., datë 08.02.2024, ERE paraqiti pranë Zyrës së Rregullatorit për Energji të Republikës (ZRRE) së Kosovë kërkesën për informacion në lidhje me vlefshmërinë e kësaj licence dhe në rast se kjo zyrë ka ndërmarrë ndonjë veprim për heqjen apo pezullimin e kësaj licence.
- Në përgjigje, me e-mailin e protokolluar në ERE me nr. 594/2 prot., datë 09.02.2024, ZRRE ka njoftuar se nuk ka filluar dhe as ka ndërmarrë ndonjë vendim për heqjen apo pezullimin e kësaj licence.
- Subjekti ka depozituar në ERE të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga neni 4, pika 3 dhe shtojca 1/K e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, si dhe ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A të rregullores.

- Afati i njohjes së licencës do të jetë i njëjtë me afatin e licencës së lëshuar nga ZRRE, pra deri më 17.08.2028.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të miratojë njohjen e licencës për tregtimin e energjisë elektrike, me nr. ZRRE/Li_91/23, lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji në Republikën e Kosovës, me vendimin, V_1756_2023, datë 18.08.2023, për subjektin “MONTING” sh.p.k., që ka regjistruar në Republikën e Shqipërisë subjektin “MONTING”, degë e shoqërisë së huaj.
2. Njohja e licencës sipas përcaktimeve të pikës 1 do të jetë e vlefshme deri më 17.08.2028.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë dhe Zyrën e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI